



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 163 Akti

Nr. 149 Vendimi
Tiranë, më 20.5.2019

V E N D I M

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Firdes Shuli
Pamela Qirko
Etleda Çiftja

Kryesuese
Relatore
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. John Leonardo, në datën 17 maj 2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Sokol Binaj**, gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim “Kushtetuta”);

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji nr. 86/2016”);

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPA GJYKUESE E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime”, datë 22.7.2016; në ligjin nr. 8417, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, datë 21.10.1998, të ndryshuar; dhe në pikën 5, të nenit 3, dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, me funksionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit” ka hedhur shortin në datën 15.5.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupa gjyquese nr. ***, e përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Firdes Shuli dhe Pamela Qirko. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja znj. Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupës gjyquese të datës 25.5.2018 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Firdes Shuli, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës gjyquese, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Binaj.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Binaj, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka ose ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të

rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa nr. *** prot., datë 8.5.2018, e **Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)**, me anë të së cilës dërgohet një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Binaj. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 24.4.2019, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Binaj.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi tri kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupa gjyqësore, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 2.5.2019, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Binaj; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës së subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 3.5.2019 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e

hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 7.5.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 13.5.2019.

16. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupa gjykuese, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, në datën 13.5.2019.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Binaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 17.5.2019, ora 9:30, në mjediset e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Subjekti ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2. Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3. Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4. Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21.5. Por, referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, *Vetting*” të dorëzuar nga ana e subjektit pranë ILDKPKI-së; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e këtij subjekti dërguar në Komisioni; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, subjekti u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

23.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës “*Vetting*”, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Binaj.

23.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe nga personat e lidhur me të, si dhe në burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

¹ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

23.3. Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2) të dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

- i. 50 % të pasurisë të llojit apartament banimi, me sipërfaqe 62.9 m², të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, privatizuar nga Ndërmarrja Komunale Banesa, në bashkëpronësi me vëllanë e tij;
- ii. 50 %, të pasurisë të llojit automjet, i tipit “Citroen C3”, blerë në datën 16.10.2009 nëpërmjet kontratës së qirasë financiare tek “Tirana Bank” (*Leasing*), me vlerë 12,000 euro, në bashkëpronësi me bashkëshorten.

24. Apartament banimi, me sipërfaqe 62.9 m², i ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

- i. vlera e deklaruar: 16,920 lekë në kohën e privatizimit;
- ii. pjesa në përqindje: 50 % në bashkëpronësi me të vëllanë, z. A.B.;
- iii. burimi i krijimit: nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

24.1. Sipas vetëdeklarimit të bërë nga ana e subjektit, ky apartament është regjistruar në zyrën e hipotekës në datën 8.10.2003, në Zyrën e Regjistrimit Tirana ***, zona kadastrale nr. *** (numri i pasurisë ***).

25. Hetimi i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri:

25.1. ZVRPP-ja Tiranë² informon se subjekti i rivlerësimit figuron të ketë në pronësi pasurinë me nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, e llojit apartament me sip. 62.91 m².

25.2. Nga verifikimi i dosjes së kësaj pasurie rezulton se nëpërmjet kontratës së shitjes të konfirmuar me vërtetim nënshkrimi³, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesa nr. 2, Tiranë pasurinë e llojit apartament me sipërfaqe 62.91 m², me vlerë 16,920 lekë, të ndodhur në lagjen nr. ***, rruga “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë. Rezulton se kjo pasuri ka qenë e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në bashkëpronësi me vëllanë e subjektit, z. A.B., dhe se në datën 28.4.2017 është rivlerësuar në vlerën 6,731,370 lekë.

25.3. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se nëpërmjet kontratës së dhurimit⁴ të datës 2.4.2018, vëllai i subjektit, z. A.B., i ka dhuruar ½ pjesë të pandarë të këtij apartamenti, objekt hetimi.

25.4. Sipas ZVRPP-së Tiranë, pjesa takuese, objekt dhurimi, në datën 4.4.2018 është vlerësuar në vlerën prej 3,365,150 lekësh. Referuar kartelës së pasurisë së dërguar nga ZVRPP-ja Tiranë, kjo pasuri është regjistruar në emër të subjektit së rivlerësimit në datën 10.4.2018, datë në të cilën është lëshuar certifikata e re e pronësisë, ku subjekti rezulton pronar i vetëm i kësaj pasurie.

25.5. Referuar Deklaratës Periodike Vjetore të vitit 2018 (në vijim “DPV”) të dorëzuar në ILDKPKI, rezulton se subjekti ka deklaruar si shtesë pasurie përfitimin e ½ pjesë të këtij apartamenti, nëpërmjet dhurimit.

25.6. Nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerësoi se, referuar pikës 14, të nenit 3 si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. A.B., bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

² Shkresa nr. ***prot., datë 4.3.2019.

³ Vërtetim nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.12.1993.

⁴ Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol.

25.7. Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë nëse vëllai i tij ka banuar në këtë apartament, periudhën gjatë së cilës ka banuar, adresën ku banon aktualisht, nëse disponon pasuri të paluajtshme në pronësi/me qira/apo në përdorim, si edhe të shpjegojë arsyet e këtij dhurimi.

25.8. Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga e Komisionit⁵, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se: *vëllai i tij ka banuar në këtë apartament prej vitit 1989 deri në vitin 1993, kur është larguar për në qytetin e Vlorës, për të banuar me prindërit për arsye të invaliditetit të plotë të tij që prej lindjes dhe nevojës së tij të përhershme për kujdes të vazhdueshëm familjar dhe se, aktualisht ai jeton me prindërit në qytetin e Vlorës dhe nuk disponon asnjë pasuri në pronësi, me qira apo në përdorim në emër të tij. Lidhur me arsyen e dhurimit të pjesës takuese në këtë pronë ai shpjegoi se vëllai i tij, vetëm formalisht, rezultonte si bashkëpronar, për sa kohë që banesa është marrë me qira prej tij që në momentin e parë mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga Komiteti Ekzekutiv i KP-së, të Rrethit Tiranë në datën 21.12.1989, është privatizuar prej tij, si dhe është disponuar e banuar në vazhdimësi nga ana e tij.*

25.9. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë këtij Komisioni, dokumentet fotokopje si më poshtë:

- i. kontratë për privatizimin e banesës së prindërve në Vlorë⁶;
- ii. certifikatat familjare të prindërve të subjektit dhe certifikatën e të vëllait, z. A. B.;
- iii. vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore “për sëmundje të përgjithshme”, DRSSH Vlorë, datë 25.4.2016, ku vërtetohet kategoria e invaliditetit të vëllait të subjektit;
- iv. vërtetim⁷ i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Vlorë, që vërteton invaliditetin e z. A.B., si dhe faktin se dosja e tij e pensionit të invaliditetit është transferuar në DRSSH-në Vlorë në datën 1.1.1994;
- v. autorizim i lëshuar nga Komiteti Ekzekutiv i KP-së, të Rrethit Tiranë në datën 21.12.1989;
- vi. kontrata e shitblerjes e datës 6.12.1993 dhe mandati i pagesës së vlerës së kësaj banese të privatizuar.

26. Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, Komisioni arrin në konkluzionin se:

1. deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë për gjendjen e kësaj pasurie në momentin e deklaratimit; rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri;
2. subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion ligjor justifikues dhurimin e ½ pjesë takuese të kësaj pasurie nga vëllai i tij, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të pjesës së dhuruar.

27. Automjet, i tipit “**Citroen C3**”, blerë në datën 16.10.2009, nëpërmjet kontratës së qirasë financiare tek “***” (*Leasing*).

- i. vlera e deklaruar: 12,000 euro;
- ii. pjesa në përqindje: 50 % në bashkëpronësi me bashkëshorten;
- iii. burimi i krijimit: nuk ka deklaruar burimin e krijimit.

27.1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në datën 16.10.2009, me lidhjen e kontratës së qirasë financiare është paguar 30 % e vlerës së këtij mjeti, ndërsa 70 % e vlerës së mjetit, shuma prej 8,400 eurosh është paguar me këste mujore me vlerë 263 euro. Gjithashtu, subjekti ka

⁵ Pyetësori i datës 26.3.2019/ përgjigjet e sjella me e-mailin e datës 10.4.2019.

⁶ Kontratë nr. ***, prot., datë 11.8.1993.

⁷ Vërtetim nr. *** prot., datë 2.4.2019.

deklaruar se në datën 29.12.2012, pasi janë shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj “Tirana Bank”, automjeti ka kaluar në pronësi të bashkëshortes së tij, znj. L.B., sipas certifikatës së pronësisë nr. ***, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor Tiranë.

28. Hetimi i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri:

28.1. DPSHTRR-ja, ka dërguar dosjen e plotë të këtij automjeti. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar rezulton se shoqëria “****”, me anë të faturës tatimore⁸, i ka shitur bashkëshortes së subjektit, znj. L.B, automjetin e markës “Citroen C3”, me vlerë prej 12,000 eurosh, konvertuar 1,638,000 lekë.

28.2. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri rezulton se, në datën 16.10.2009 bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontratën e qirasë financiare⁹ me shoqërinë “****” sh.a., për automjetin tip “Citroen C3”, me vlerë 12,000 euro, me financim 8,400 euro, me kohëzgjatje 3 vjet. Kjo shoqëri ka konfirmuar se në dhjetor të vitit 2012, znj. L.B., e ka mbyllur kontratën *leasing*, duke shlyer plotësisht të gjitha detyrimet që kanë lindur prej saj dhe se nuk ka asnjë detyrim të prapambetur.

28.3. Gjithashtu, konstatohet se në datën 29.12.2012, mes shoqërisë “****” sh.a., dhe bashkëshortes së subjektit është lidhur kontrata e shitblerjes¹⁰ për këtë automjet.

28.4. Referuar DPV-së të vitit 2009 të dorëzuar në ILDKPKI, rezulton se subjekti e ka deklaruar këtë automjet, vlerën totale të tij, pagesën fillestare të kryer në shumën prej 3,600 eurosh, si edhe vlerën e këstit mujor. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar si detyrim ndaj shoqërisë “****” sh.a., shumën prej 7,984 eurosh, të mbetur pa shlyer në datën 31.12.2009.

28.5. Plani i pagesave për blerjen e këtij automjeti, referuar dokumentacionit të shoqërisë qiradhënëse¹¹, pasqyrohet si më poshtë:

- i. për vitin 2009 është paguar shuma prej 4,252.4 eurosh;
 - ii. për vitin 2010 është paguar shuma prej 3,158.4 eurosh;
 - iii. për vitin 2011 është paguar shuma prej 3,156 eurosh;
 - iv. për vitin 2012 është paguar shuma prej 2895.2 eurosh;
- Totali i pagesave të kryera, shuma prej 13,462 eurosh.

28.6. Në shpjegimet e sjella pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se burim i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga pagat.

28.7. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, u krye analiza e tregueseve financiarë për vitet 2009 – 2012. Nga analiza e të dhënave lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur, konstatohet se për vitet 2009 – 2012 rezulton një balancë pozitive e fondeve.

29. Për sa më sipër, nga hetimi i kryer lidhur me këtë pasuri, Komisioni arrin në konkluzionin se:

1. deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje;
2. subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur aftësi paguese nga burime financiare të ligjshme për kryerjen e pagesave për vitet 2009 – 2012, për blerjen e këtij automjeti.

30. Pasuria e llojit apartament, dhuruar nga e motra e subjektit, znj. V.D (B).

⁸ Fatura nr. serial ***, datë 12.10.2009.

⁹ Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol.

¹⁰ Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol.

¹¹ Dokumentacionin administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

30.1. ZVRPP-ja Tiranë ka informuar¹² Komisionin se subjekti i rivlerësimit figuron të ketë në pronësi edhe pasurinë me nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, e llojit apartament me sip. 77.97 m², pasuri kjo e krijuar pas dorëzimit të deklaratës “Vetting” (shtojca 2) në ILDKPKI.

30.2. Kjo pasuri është përfituar nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kontratës së dhurimit¹³, të datës 18.5.2017. Referuar kësaj kontrate, motra e subjektit, znj. V.D., i ka dhuruar pasurinë e llojit apartament, të ndodhur në Tiranë, rruga “***”, p. ***, shk. ***, k. ***, me sip. 77.97 m².

30.3. Referuar DPV-së së vitit 2017 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë pasurie këtë apartament të dhuruar nga ana e së motrës.

30.4. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se:

- i. kjo pasuri është blerë nga motra e subjektit, znj. V.D (B)., në vitin 1993, nga Ndërmarrja Komonale Banesa nr. 2 Tiranë, për vlerën prej 23,848 lekësh dhe është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në emër të saj dhe bashkëshortit (më vonë të divorcuar);
- ii. në datën 15.8.2009, motra e subjektit i ka blerë¹⁴ z. K.D., (ish-bashkëshorti), ½ pjesë takuese të kësaj pasurie, në shumën prej 2,730,000 lekësh;
- iii. në datën 28.2.2017, znj. V.D., emëron¹⁵ subjektin e rivlerësimit si përfaqësues të posaçëm, që në emër dhe për llogari të saj të nënshkruajë kontratën e dhurimit të kësaj pasurie;
- iv. në datën 28.4.2017, kjo pasuri është rivlerësuar në ZVRPP-në Tiranë, në vlerën prej 8,342,790 lekësh;
- v. në datën 18.5.2017 është nënshkruar kontrata e dhurimit.

30.5. Nga të dhënat e referuara në analizën e apartamentit të privatizuar nga subjekti në vitin 1993, trajtuar më sipër, duket se këto dy pasuri kufizohen me njëra-tjetrën.

31. Nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerësoi se, referuar pikës 14, të nenit 3 si edhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, znj. V. B., bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

31.1. Komisioni i kërkoi subjektin, ndër të tjera, të deklarojë: (1) nëse këto dy apartamente janë bashkuar në një të vetëm, periudhën kur janë bashkuar dhe shpenzimet e kryera për bashkimin e tyre, si dhe; (2) mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 2,730,000 lekësh, të paguar nga motra e subjektit për blerjen e ½ pjesë të këtij apartamenti.

31.2. Në përgjigje të pyetësorit¹⁶ të dërguar nga Komisioni subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se: *ky apartament (apartamenti që i ka dhuruar e motra) ndodhet në të njëjtin kat dhe të njëjtin krah me apartamentin e tij (ngjitur) dhe se që prej momentit të përpilimit të kontratës së dhurimit, viti 2017, apartamenti përdoret nga ana e tij, i adaptuar nëpërmjet ndryshimesh të vogla me vlerë të parëndësishme, është hapur vetëm muri që lidh dy korridoret e dy apartamenteve që ishin në të njëjtin krah dhe komunikohet normalisht me njëri tjetrin, nuk ka ndryshuar asnjë prej hyrjeve të këtyre apartamenteve, të cilat janë si në gjendjen para bashkimit në një të vetëm. Në vijim ka deklaruar se, ky apartament i është dhuruar nga motra e tij për shkak të mundësive të kufizuara financiare të familjes së tij për të siguruar një sipërfaqe të mjaftueshme banimi si edhe njëkohësisht për shkak të mundësisë ekonomike e financiare shumë herë më të mirë të motrës së tij, pra i një disponibiliteti financiar, i garantuar prej aktiviteti tregtar që ajo administron në shtetin Italian, në qytetin e Romës, ku ndodhet për*

¹² Shkresa nr. *** prot., datë 4.3.2019.

¹³ Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol.

¹⁴ Kontrata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol.

¹⁵ Dokumenti noterial prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol.

¹⁶ Pyetësori i datës 26.3.2019/përgjigjet e dërguara nga subjekti me e-mail në datën 10.4.2019.

shkak të emigrimit, që prej vitit 1996. Lidhur me të të ardhurat e motrës së tij që kanë shërbyer për kryerjen e pagesës në vitin 2009 për blerjen e pjesës nga ish-bashkëshorti i saj, subjekti ka deklaruar se janë siguruar nga puna e saj në vite në emigracion përfshi të ardhurat nga aktiviteti tregtar që disponon që prej vitit 2006.

31.2.1. Subjekti ka dorëzuar si provë pranë Komisionit: (1) autorizimin e datës 14.11.1989, lëshuar nga Këshilli Popullor i Lagjes nr. *** , sipas të cilit është vendosur që znj. V.B., të strehohet në lagjen “***”, Tiranë, pikërisht në apartamentin objekt hetimi; (2) kontratë shitjeje e vitit 1993, sipas së cilës znj. V.D., (B) ka blerën nga Ndërmarrja Komunale Banesa nr. 2 këtë apartament dhe; (3) mandatpagesën sipas të cilit vërtetohet kryerja e pagesës për blerjen e këtij apartamenti nga znj. V.D.B.

32. Për të provuar mundësinë financiare të krijimit të të ardhurave të ligjshme të mjaftueshme nga e motra e subjektit për blerjen e pjesës prej ½ të kësaj pasurie objekt hetimi, subjekti fillimisht dorëzoi dokumentacion fotokopje në gjuhën italiane lidhur me të ardhurat e përfituara nga e motra e tij në shtetin italian.

32.1. Komisioni konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nga ana e subjektit lidhur me burimin e krijimit të shumës për blerjen e ½ së kësaj pasurie, nuk ishte në formën e kërkuar nga ligji dhe në gjuhën zyrtare sipas parashikimeve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

33. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i ula barra e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me burimet e financiare që kanë shërbyer për blerjen e ½ pjesë të apartamentit nga e motra në vitin 2009, duke i kërkuar që i gjithë dokumentacioni lidhur me të ardhurat e përfituara nga e motra në shtetin italian, të legalizohet, të përkthehet në gjuhën shqipe dhe të noterizohet.

33.1. Në prapësimet¹⁷ e sjella pranë Komisionit, subjekti ka shpjeguar se: referuar dokumentacionit, të cilin e ka dorëzuar në KPK, rezulton se të ardhurat e motrës së tij që i përkasin periudhës 2000 – 2010 kanë qenë më se të mjaftueshme për të blerë ½ e pjesë të këtij apartamenti. Ai sqaron se gjatë viteve 2000 deri në vitin 2010, motra e tij znj. V.D., ka realizuar të ardhura në cilësinë e bashkëpunëtores familjare, dhe se në vitin 2007 ajo bëhet titullare e një aktiviteti privat, nga i cili ka realizuar të ardhura në vazhdimësi.

33.2. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit dokumentacionin e legalizuar (me vulë APOSTILE), të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, lidhur me të ardhurat e përfituara nga motra e tij, znj. V.D, si më poshtë:

- i. të ardhura të siguruara nga punësimi i znj. V.D., referuar ekstraktit të Sigurimeve Shoqërore lëshuar në datën 23.4.2019 nga INPS-ja¹⁸, paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Periudha	Bashkëpunëtores familjare / euro	Titullar shoqërie / euro	Shuma / euro
2000	5,565.85	0	5,565.85
2001	5,018	0	5,018
2002	5,161	0	5,161
2003	5,291	0	5,291
2004	5,357.7	0	5,357.7

¹⁷ Sqarimet e dërguara me e-mail-in e datës 13.5.2019.

¹⁸ Dorëzuar si provë në protokollin e Komisionit, protokolluar me tonën nr. *** prot., datë 13.5.2019.

2005	6,285.47	0	6,285.47
2006	6,142.46	0	6,142.46
2007	5,733	1,133.17	6,866.17
2008	5,824	1,151.58	6,975.58
2009	4,863	1,186.67	6,049.67
Totali	55,241.48	3,471.42	58,712.9

- ii. të ardhurat sipas formularëve të agjencisë së të dhënave (në Itali) për personin fizik V.D.¹⁹, për periudhën 2006 – 2009, paraqiten në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Periudha	Datë dorëzimi formulari	Të ardhura bruto / euro	Të ardhura të tatueshme / euro	Tatim dhe taksa për t'u paguar
2006	28.9.2007	3,275	0	0
2007	31.7.2008	5,235	5,235	347
2008	29.9.2009	4,112	4,112	0
2009	23.9.2010	10,301	9,401	0
Totali		22,923	18,748	347

34. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar se ka filluar të përdorë këtë apartament pas nënshkrimit të kontratës së dhurimit. Gjithashtu, në shpjegimet e tij ka sqaruar se e motra ka qenë emigrante në shtetin italian që prej vitit 1996 dhe se, pavarësisht se ka punuar vazhdimisht, vetëm në vitin 2000 u formalizua në punë. Gjatë kësaj periudhe, subjekti shpjegon se e motra ka punuar si “bashkëpunëtoresh familjare” nëpër 3-4 familje të ndryshme, duke kryer disa punë njëherësh, por se vetëm njëra nga ato familje e formalizoi, të dhënat e punësimit të së cilës janë pasqyruar më sipër. Në vitin 2007, motra e subjektit ka filluar edhe një punë tjetër, punë të pavarur, me aktivitet dhënie mjetesh me qira, nga e cila ka përfituar të ardhura, të cilat janë pasqyruar deri në vitin 2009 në tabelën e mësipërme.

34.1. Lidhur me arsyet e këtij dhurimi subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna (pyetësorë/prapësime/seancë dëgjimore), ka deklaruar se më parë e ka ndihmuar financiarisht të motrën, duke e pritur si emigrante në shtetin italian bashkë me fëmijët e saj, duke kontribuar në jetesën e saj, si edhe duke i krijuar mundësi për punësim. Siç shprehet edhe e motra në letrën e dërguar pranë Komisionit²⁰, ky dhurim është bërë për këto arsye, në kushtet kur ajo e ndiente si detyrë morale, njerëzore dhe shpirtërore të lehtësonte sado pak jetesën e vëllait të saj.

35. Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar lidhur me këtë pasuri, si edhe shpjegimeve të dhëna nga ana e subjektit, Komisioni vlerëson se:

1. deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit; dhe
2. personi tjetër i lidhur/motra e subjektit të rivlerësimit paraqiti dokumentacion justifikues ligjor që provoi se disponon të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për

¹⁹ Dorëzuar si provë në protokollin e Komisionit, protokolluar me tonën nr. *** prot., datë 16.5.2019.

²⁰ Dorëzuar me përgjigjet e dërguara nga subjekti me e-mail në datën 10.4.2019.

blerjen e ½ pjesë të kësaj pasurie në vitin 2009, pasuri e cila i është dhuruar subjektit të rivlerësimit.

36. Pasuria e llojit apartament, ku bashkëshortja e subjektit figuron bashkëpronare

36.1. Nga hetimi i kryer ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit, znj. L.B., figuron të jetë bashkëpronare (me prindërit) në pasurinë me nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, e llojit apartament me sip. 75 m². Kjo pasuri, dhe konkretisht pjesa takuese e saj, nuk është pasqyruar në deklaratën “Vetting” nga bashkëshortja e subjektit.

36.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se kjo pasuri është përfituar nga babai i bashkëshortes së subjektit, z. E.M., me anë të kontratës për privatizimin e banesës (të nënshkruar vetëm nga ai në cilësinë e blerësit) të lidhur me Ndërmarrjen Komunale Banesa, në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

36.3. ZVRPP-ja Tiranë²¹ ka dërguar dy kartela të kësaj pasurie. Referuar kartelës së parë rezulton se kjo pasuri është regjistruar në datën 2.12.1997 në emër të shtetasit E.M., por në rubrikën “Përshkrim i veçantë” mban shënimin me shkrim të lirë dore “mungon kontrata e shitjes dhe certifikata familjare”. Ndërsa, nga verifikimi i kartelës së dytë, e cila duket se është printuar nga sistemi digjital i regjistrimit të pasurive, rezulton se kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të shtetasve R.B.M., E.D.M., dhe L.E.B. Si datë e regjistrimit të kësaj pasurie konfirmohet data 2.12.1997, por certifikata e pronësisë rezulton se është lëshuar në datën 10.5.2017.

36.4. Nga analizimi i të dhënave të mësipërme duket se personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) është regjistruar si bashkëpronare e kësaj pasurie në maj të vitit 2017, dhe se referuar nenit 9, të ligjit nr. 7652, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, datë 23.12.1992, ka përfituar 1/3 e kësaj pasurie si anëtare madhore e familjes në momentin e privatizimit të saj.

36.5. Subjekti, lidhur me këtë pasuri, ndër të tjera ka sqaruar²² se: *bashkëshortja e tij nuk ka qenë në dijeni të këtij fakti. Ajo nuk ka pasur për qëllim fshehje të kësaj bashkëpronësie, për sa kohë që dokumentimi i këtij fakti është bërë në maj të vitit 2017.*

37. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, si edhe në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti lidhur me këtë pasuri, Komisioni vëren se bashkëpronësia për këtë pasuri është fituar për shkak të ligjit dhe jashtë periudhës së ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit. Për më tepër, duket se në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” kjo pasuri ka qenë e regjistruar vetëm në emër të z. E.M., babai i personit të lidhur.

38. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i 1/3 pjesë të këtij aseti në deklaratën “Vetting” nuk ka pasur si qëllim fshehjen e pasurisë, pasi subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm se ky mosdeklarim ka ardhur si pasojë e mospasjes dijeni të të qenët bashkëpronar në një bashkëpronësi që rrjedh nga familja e origjinës, ku burimi i krijimit është i legjitimuar.

39. Likuiditetet

39.1. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara në ILDKPKI rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar shtesa/pakësime/gjendje likuiditeti në bankë apo *cash* jashtë sistemit bankar. Edhe në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh.

39.2. Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij konstatohet se nuk janë deklaruar gjendjet e tyre në fund të vitit, të cilat kryesisht kanë qenë në vlera të vogla. Evidentohet gjendja e llogarisë bankare e subjektit në “Raiffeisen Bank” në fund

²¹ Shkresa nr. *** prot., datë 4.3.2019.

²² Sqarimet e dërguara me *e-mail-in* e datës 13.5.2019.

të vitit 2007 në vlerën prej 105,541 lekësh, si edhe gjendja e llogarisë bankare e bashkëshortes së tij në “Credins Bank” në fund të vitit 2010, në vlerën prej 542,798 lekësh. Gjithsesi, konfirmohet se të dyja këto llogari kanë qenë llogari page, llogari ku disbursohej paga e subjektit dhe e bashkëshortes së tij.

39.3. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në deklaratimet e bëra nga ana e subjektit, është kryer analiza e treguesve financiarë për vitet 2007 dhe 2010, vite në të cilat janë krijuar këto pasuri (gjendjet e likuiditeteve në bankë). Nga analiza e të dhënave lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur me të, konstatohet se për vitet 2007 dhe 2010 rezulton balancë pozitive e fondeve.

40. Lidhur me këto konstatime subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar²³ se: *në thelb bëhet fjalë për llogari bankare dhe të ardhura të deklaruara nga ana e tij, si edhe likuiditete për të cilat ILDKPKI ka pasur akses. Për rrjedhim, ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë lloj qëllim fshehjeje, pasi të gjitha veprimet janë të dokumentuara saktësisht dhe të kontrollueshme në çdo kohë lehtësisht nga institucionet.*

41. Nisur nga fakti se kemi të bëjmë me gjendje llogarie page të krijuara nga mostërheqja e një pjese të saj, si edhe faktit se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë burime financiare të ligjshme për krijimin e këtyre gjendjeve në llogari bankare në fund të vitit 2007 dhe 2010, Komisioni vlerëson se në këtë rast nuk mund të ngrihen dyshime se subjekti dhe bashkëshortja e tij të kenë pasur si qëllim mosdeklarimin apo fshehjen e tyre.

42. Gjithsesi, Komisioni çmon se këto janë pasaktësi në deklaratimet periodike ndër vite, të cilat nuk sjellin pasoja në këtë proces, pasi nuk cenojnë ligjshmërinë e burimit të këtyre llogarive bankare, për kohën kur ato janë krijuar.

43. Automjete të përdorura nga subjekti i rivlerësimit

43.1. Në përgjigje të pyetësorit²⁴ të dërguar nga Komisioni subjekti ka deklaruar se, *në vitin 2017 ka udhëtuar drejt shtetit grek për pushime dhe se për këtë udhëtim ka përdorur automjetin me targë AA *** HX, në pronësi të shtetasit G. R. Gjithashtu, ka deklaruar se ka përdorur në vitin 2011, për udhëtimin e tij në Greqi për pushime, mjetin me targë TR *** S, në pronësi të shtetasit A. R.*

43.2. Nga verifikimet e bëra nga Komisioni, rezulton se subjekti figuron i regjistruar si përdorues në policia sigurimi të tipit Karton Jeshil dhe Policë Kufitare për periudhën dhe mjetet me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Lloji i sigurimit	Lloji i mjetit	Targa	Datë fillimi	Datë mbarimi
1.	Karton Jeshil	MERCEDEZ BENZ GLE 350 D	AA***PN	1.8.2018	31.8.2018
2.	Karton Jeshil	BMW X6	AA***HX	29.7.2017	28.8.2017
3.	Policë Kufitare	MERCEDEZ BENZ GLE 350 D	AA***PN	1.8.2018	31.8.2018
4.	Policë Kufitare	BMW X6	AA***HX	29.7.2017	28.8.2017

43.3. Këto automjete figurojnë të jenë në pronësi të shtetasve A.R., dhe G.R.

²³ Sqarimet e dërguara me e-mail-in e datës 13.5.2019.

²⁴ Pyetësori nr.1, i datës 2.10.2019 / përgjigjet e sjella nga subjekti me e-mail-in e datës 12.10.2019.

44. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për marrëdhënien e tij me shtetasit e sipërcituar, si dhe të depozitohë dokumentacion justifikues ku të konfirmohet nëse ka gjykuar/nuk ka gjykuar çështje penale/civile me palë këto dy shtetas.

45. Në prapësimet²⁵ e tij të depozituara pranë Komisionit subjekti ka sqaruar se: *me shtetasit e mësipërm ka prej vitesh miqësi familjare, prej marrëdhënieve të prindërve të cilët kanë qenë nga e njëjta zonë, të lidhur midis tyre nga marrëdhëniet e miqësisë dhe krushqisë. Përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin e gjyqtarit (edhe në rastin kur ka qenë i deleguar në gjykata të tjera) deklaroi se nuk ka shqyrtuar asnjë çështje që ka të bëjë me këta shtetas. Këto automjete, thotë se i ka përdorur për raste të pushimeve për udhëtime të kryera jashtë shtetit, në Greqi, për shkak se automjeti në pronësi të bashkëshortes ka karakteristika të kufizuara dhe është i destinuar kryesisht për të udhëtuar në distanca të shkurtra.*

45.1. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit provat shkresore, dokumentet si më poshtë:

- i. vërtetim²⁶ nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda se nuk është regjistruar (shqyrtuar) asnjë çështje në emër të shtetasve A., dhe G. R.;
- ii. vërtetim²⁷ nga Gjykata e Apelit Korçë se nuk rezulton asnjë çështje e regjistruar në këtë gjykatë me palë shtetasit A., dhe G.R.;
- iii. vërtetim²⁸ nga Gjykata e Apelit Shkodër se gjyqtari Sokol Binaj nuk ka gjykuar si i komanduar në këtë gjykatë çështje (penale, civile) që i përket shtetasve A., dhe G. R.;
- iv. vërtetim²⁹ nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë se shtetasit A., dhe G.R., nuk ka qenë palë në ndërgjyqje në asnjë proces gjyqësor penal apo civil në këtë gjykatë;
- v. vërtetim³⁰ nga Gjykata e Apelit Durrës se kjo gjykatë nuk rezulton të ketë gjykuar çështje gjyqësore, civile apo penale, për periudhën 2004 – 2019, që t'i përkasë palëve A., dhe G.R.;
- vi. vërtetim³¹ nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime Rënda Tiranë se nuk rezulton që ndaj këtyre dy shtetasve të ketë filluar ndonjë procedim penal;
- vii. vërtetim³² i gjendjes gjyqësore i shtetasit A.R.;
- viii. vërtetim³³ i gjendjes gjyqësore i shtetasit G.R.

46. Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe i shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit përputhen me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit. Me dokumentacion ligjor justifikues provohet edhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë arsye që mund ta pengonte në përdorimin e një mjeti në pronësi të të tretëve.

Nuk disponohen të dhëna që shtetasit e sipërcituar, të cilët i kanë dhënë në përdorim këto automjete, të jenë me rekorde kriminale, të përfshirë në krimin e organizuar ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar. Subjekti nuk ka marrë pjesë në asnjë proces gjyqësor me palë z. A.R., dhe z. G.R., pra, nuk është gjendur në konflikt interesi.

47. Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

²⁵ Prapësimet dorëzuar si provë në protokollin e Komisionit, protokolluar me tonën nr. *** prot., datë 13.5.2019.

²⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 6.5.2019.

²⁷ Vërtetim nr. *** prot., datë 7.5.2019.

²⁸ Vërtetim nr. *** prot., datë 8.5.2019.

²⁹ Vërtetim nr. *** prot., datë 7.5.2019.

³⁰ Vërtetim nr. *** prot., datë 6.5.2019.

³¹ Vërtetim nr. *** prot., datë 10.5.2019.

³² Vërtetim nr. *** prot., datë 6.5.2019.

³³ Vërtetim nr. *** prot., datë 6.5.2019.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se:

- i. subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorim të tij.
- iii. Deklarimet e pamjaftueshme të konstatuara si më sipër nuk janë në atë shkallë sa të përbëjnë shkak për shkarkim sipas pikës 3, të nenit 61 dhe nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut tek drejtësia.

Për sa më sipër, trupa gjyquese vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

48. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “**DSIK**”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

48.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar parë Komisionit raportin³⁴ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Sokol Binaj, ku ka konstatuar se:

- i. formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;
- ii. subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës;
- iii. për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar;
- iv. në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol M. Binaj.

Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. ***, datë 24.4.2019.

49. Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës

49.1. Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

49.2. Trupa gjyquese vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

³⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 2.11.2017.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

50. C/1 Raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor

50.1. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

50.2. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin: (1) e formularit të vetëdeklarimit, e tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (2) e pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) e të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

50.3. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

51. Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit: subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, prej muajit shkurt 2004 e në vazhdim, pra, edhe aktualisht, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.

52. Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së: sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore për gjyqtarin Sokol Binaj përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

53. Aftësitë profesionale

53.1. *Njohuritë ligjore:* subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

53.2. *Arsyetimi ligjor:* subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Subjekti i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat jo vetëm tregohet shkaku ligjor, por jepet përmbledhur edhe shkaku i pranimin apo i rrëzimit të kërkesave të palëve ndërgjyqëse.

54. Aftësitë organizative

54.1. *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë:* bazuar në të dhënat statistikore të përcjella nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, lidhur me çështjet e caktuara për periudhën objekt vlerësimi, çështjet e përfunduara dhe rendimentin e përfundimit të tyre, konstatohet se mesatarja e gjykimit për subjektin, z. Sokol Binaj, është 19 çështje penale në vit, pranë standardit sasior të vendosur nga ish-KLD-ja. Rezultoi se të gjitha çështjet që i përkasin dosjeve të përzgjedhura me short janë gjykuar brenda afatit kohor të përcaktuar nga ligji i posaçëm apo sipas vendimit të ish-KLD-së. Gjyqtari Sokol Binaj ka respektuar afatet ligjore dhe standarde të gjykimit, edhe në të tria dokumentet (vendimet gjyqësore) që ka dorëzuar bashkëngjitur

formularit të vetëvlerësimit. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimet e pesë dosjeve të shortuara rezultoi se arsyetimi i vendimeve është kryer në interval kohor nga pesë ditë, deri në një muaj. Në analizë të të dhënave të mësipërme, mund të thuhet se subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, përgjithësisht është eficient dhe efektiv. Respekton kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Në të gjitha rastet e vëzhguara gjykimet kanë përfunduar brenda afateve të arsyeshme.

54.2. *Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*: subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj ka treguar se ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore.

54.3. *Aftësia për të administruar dosjet*: nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, te gjyqtari Sokol Binaj janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet. Procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal. Në katër nga pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

55. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

55.1. *Etika në punë*: sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtarin Sokol Binaj është paraqitur një ankesë në vitin 2014, e cila nuk lidhet me etikën në punë. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore për gjyqtarin Sokol Binaj përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

55.2. *Integriteti*: nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

55.3. *Paanësia*: nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Binaj. Gjithashtu, në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, të mos ketë respektuar rregullat procedurale.

56. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

56.1. *Aftësitë e komunikimit*: në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalin gjyqësor në format letër, nuk ka të dhëna të plota për mënyrën e komunikimit të subjektit, z. Sokol Binaj me palët ndërgjyqëse. Nga dëgjimi i kasetës, që i bashkëlidhet dosjes gjyqësore, rezultoi se komunikimi i gjyqtarit Sokol Binaj me palët pjesëmarrëse në proces ka qenë korrekt dhe në respektim të normave etike. Në të tria dokumentet ligjore dhe në të pesta dosjet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

56.2. *Aftësia për të bashkëpunuar*: në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit, z. Sokol Binaj për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

56.3. *Gatishmëria për t'u angazhuar*: në periudhën e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 5 seminare me 10 ditë trajnimi gjithsej, të organizuara nga

Shkolla e Magjistraturës. Konstatohet se pjesëmarrja e këtij gjyqtari në seminarin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës është e pakët.

57. C/2 Denoncimet e publikut të depozituara pranë Komisionit

Mbi denoncimet e ardhura në Komision për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Binaj

i. Denoncimi nr. * prot., datë 6.3.2018. Denoncues: znj. D.K.**

57.1. Denoncuesja, znj. D.K., denoncon ndër të tjerë edhe subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Binaj për dhënie vendimi të padrejtë, duke pretenduar se ka favorizuar palën kundërshtare për qëllime përfitimi.

57.2. Denoncuesja përmend në denoncim emrin e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëlidhur ka paraqitur një ankesë, ku ka cituar vetëm vendime gjyqësore. Për subjektin e rivlerësimit ka cituar vendimin nr. ***, me gjyqtarë A.L., N.D., dhe Sokol Binaj.

57.3. Me prapësimet³⁵ e sjella subjekti ka evidentuar se ky vendim gjyqësor ka të bëjë me një çështje civile të gjykuar nga ana e tij, si pjesë e trupës gjyqësore të Gjykatës së Apelit Durrës.

57.4. Nga verifikimi i këtij vendimi, të cilin subjekti e ka paraqitur si provë, rezulton se denoncuesja nuk ka qenë palë në këtë proces dhe se as personi i përmendur në denoncim si trashëgimlënësi i saj nuk rezulton në përmbajtje të vendimit.

57.5. Në këtë vendim nuk është zgjidhur konflikti civil në themel. Gjykata ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë për arsye të pavlefshmërisë së konstatuar si rezultat i mosformimit të rregullt të ndërgjyqësisë.

57.6. Nga shqyrtimi i këtij denoncimi vërehet se denoncuesi nuk paraqiti asnjë rrethanë apo provë konkrete që të lidhte subjektin e rivlerësimit me veprime korruptuese, shkelje të etikës së gjyqtarit apo shkelje procedurale të kryera gjatë gjyqimit.

57.7. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Binaj.

ii. Denoncimi nr. * prot., datë 15.11.2018. Denoncues: E.L.**

58. Denoncohet subjekti i rivlerësimit, z. Sokol Binaj, si anëtar i trupës gjyqësore të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë (i deleguar nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda) se ka marrë vendim haptazi në kundërshtim me ligjin, si edhe ka shkelur etikën e gjyqtarit. Gjithashtu, denoncuesi hedh dyshime për qëndrime korruptuese të këtij gjyqtari dhe gjyqtarëve të tjerë që kanë shqyrtuar këtë çështje.

58.1. Vendimet e marra nga gjykatat, lidhur me çështjen objekt ankimi.

58.1.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, e përbërë nga gjyqtari S.P., me vendimin e saj nr. ***, datë 16.1.2016, për çështjen me: (1) paditës, E.L.; (2) të paditur, E.H., e të tjerë...; (3) me objekt: njohje e pavërtetësisë për shkak falsiteti të disa dokumenteve, ka vendosur rrëzimin e padisë.

58.1.2. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 5.7.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

58.1.3. Referuar këtij denoncimi dhe nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur me të, konstatohet se denoncuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

³⁵ Sqarimet dhe provat e dërguara me *e-mail-in* e datës 13.5.2019.

58.2. Nga shqyrtimi i këtij denoncimi vërehet se denoncuesi nuk paraqiti asnjë rrethanë apo provë konkrete që të lidhte subjektin e rivlerësimit me veprime korruptuese apo shkelje të etikës së gjyqtarit. Gjithashtu, denoncuesi nuk paraqiti asnjë fakt për ndonjë shkelje procedurale të subjektit të rivlerësimit.

58.3. Për sa i përket pjesës së denoncimit që ka të bëjë me vendimmarrjen, Komisioni vlerëson se, bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësimi i aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit çmohet pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si edhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën që vlerësohet.

58.4. Nisur nga sa më sipër, Komisioni çmon se nuk mund të komentohet një vendim gjyqësor apo zgjidhja e dhënë prej tij, për sa kohë ky vendim është në fuqi dhe nuk është ndryshuar nga një gjykatë më e lartë dhe, aq më pak, të ngarkohen me përgjegjësi gjyqtarët që e kanë dhënë këtë vendim. Ky argument bazohet edhe në Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 11, datë 27.5.2004 të saj, ka sanksionuar detyrimin sipas të cilit: *“Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga një gjykatë më e lartë, e se asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë”*.

59. Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

59.1. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, si edhe dy denoncimeve të depozituara ndaj këtij subjekti pranë Komisionit, si më sipër, trupa gjykuese nuk gjeti asnjë indice apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

59.2. Mbështetur në raportin e KLGJ-së dhe në shqyrtimin e dy denoncimeve, trupa gjykuese vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

59.3. Për sa në sipër, trupa gjykuese arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupa gjykuese i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në pikën 2, të nenit 4; germën “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 1, të nenit

59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Sokol Binaj, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.
 2. Ky vendim i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
 4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, në datën 20.5.2019

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

Firdes Shuli
Kryesuese

Etleda Çiftja
Anëtare

Pamela Qirko
Relatore

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore